



KËSHILLI PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE E TË LIRIVE TË NJERIUT
COUNCIL FOR THE DEFENCE OF HUMAN RIGHTS AND FREEDOMS

Rr. Nëna Terezë nr. 24/2 – I/I, Prishtinë-Kosovë; tel. 381 (0) 249006 fax: 381 (0) 38 244029

E-mail: kmdl nj.cdhrf@gmail.com; <http://www.cdhrf.org>

Letër e KMDLNJ – së drejtuar Presidentit të Kosovës për faljen e të burgosurve

I nderuari z. President ,

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut në Prishtinë është themeluar me 14 dhjetor 1989 dhe deri më tani ka aktivitet të pandërprerë në përmbushjen e misionit për mbrojtjen , përparimin dhe promovimin e të drejtave të njeriut në përgjithësi si dhe mbrojtjen e të drejtave të grupeve të marginalizuara në veçanti. Në grup të marginalizuar , KMDLNj , në bazë të mandatit që e ka , trajton të drejtat e personave të privuar nga liria , si në aspektin e respektimit të procedurave , trajtimit të tyre , gjatë mbajtjes së dënimit dhe risocializimin e tyre si kusht i domosdoshëm për integrimin e tyre në shoqëri pasi ta kenë përfunduar masën e shqiptuar nga Gjykata kompetente.

Personat e privuar nga liria është kategoria e cila më së paku ka përfituar pas përfundimit të luftës dhe pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës.

Nëse gjatë kohës kur kompetencat ekzekutive në fushën e ekzekutimeve të sanksioneve penale kanë qenë në duar dhe përgjegjësi të ndërkombëtarëve andaj nuk ka pasur trajtim afirmativ të personave të privuar nga liria që përmes faljes , amnistisë apo formave të tjera të fitimit të lirisë të kontribuohet që programi i risocializimit të tyre të jetë i suksesshëm dhe integrimi i tyre në shoqëri të shndërrohet në proces normal , pas shpalljes së pavarësisë është dashur të krijohen kushtet që personat e privuar nga liria të përfitojnë më shumë sikur që ka ndodhur në vendet e rajonit ku ka pasur ndryshime rrënjësore të sistemit apo të kalimit nga totalitarizmi në demokraci!

Në Republikën e Kosovës nuk ka Ligj për Amnisti ndonëse janë plotësuar të gjitha parakushtet për këtë dhe mungesa e këtij ligji ka shkaktuar shumë probleme në punën e Shërbimit

Korrektues të Kosovës si dhe ka pasur greva dhe kryengritje të të burgosurve në realizim të kësaj të drejteje.

Si pasojë e kësaj , në vitin 2003 janë mbytur 5 të burgosur ndërsa rëndë dhe lehtë janë lënduar mbi 100 të burgosur. Pritjet e të burgosurve për falje nga presidentja e Kosovës në dy vitet e fundit janë shndërruar në ankth për të burgosurit , familjet e tyre si dhe oficerët dhe menaxhmentin e Sherbimit Korrektues të Kosovës ngase numri i të falurve ka qenë zero (0) të falur.

Edhe në vitet paraprake ka qenë një numer simbolik i të falurve , qoftë për shkak të ndërhyrjes së opinionit që ka pasur dhe ka mungesë të theksuar të informatave për të drejtat e personave të privuar nga liria qoftë se është përdorur për qëllime politike dhe qoftë për shkak të ndërhyrjeve të ndërkombëtarëve në mënyrë individuale apo institucionale.

E drejta për falje nga Presidenti është e drejtë ekskluzive e presidentit dhe askush nuk ka të drejtë ndërhyrjeje qoftë për t'i liruar nëse nuk i meritojnë , ta kufizojnë numrin sa duhet të lirohen apo të bëjnë presion të mos lirohen.

I nderuari z. President ,

Në kohën kur po ndryshohet edhe infrastruktura ligjore që po afirmon masat alternative të dënimit në Kosovë e që kanë dhënë rezultate pozitive në vendet e rajonit e sidomos në vendet me demokraci të zhvilluar dhe konsoliduar , mohimi i një të drejte njerëzore (nëse dikush dënohet i humb disa të drejta përkohësisht por nuk mund t'u mohohen të drejtat e personave të privuar nga liria) paraqet një prapakthim në trajtimin e të burgosurve , diskriminim flagrant , shpenzim të shtuar dhe të panevojshëm të buxhetit të Kosovës , destimulim për sjellje të mirë të të burgosurve , vështërsi të mëdha për oficerët korrektues dhe drejtuesit e Sherbimit Korrektues të Kosovës , pamundësi për zbatimin e një programi për risocializim për të burgosurit e kjo shprehimisht nënkupton se integrimi i tyre në shoqëri do të shndërrohet në një mision të pamundur e që për pasojë logjike do ta ketë rritjen e shkallës së recidivizmit dhe rritjen e kriminalitetit në shoqëri.

KMDLNj , gjithashtu kërkon që edhe të dënuarit për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit , të trajtohen në përputhje me dokumentet ndërkombëtare dhe si shembull se si ata duhet të trajtohen është Tribunali i Hagës i cili asnjë të dënuar për vepra të shkeljes së të Drejtës Humanitare dhe Zakoneve të Luftës nuk e diskriminon por të gjithëve ua njeh të drejtën e beneficioneve dhe nuk ka asnjë rast i dënuar nga ky Tribunal që nuk ka fituar nga lirimi i parakohshëm , ndërprerja e dënimit apo ndonjë masë tjetër. Kategoria e të dënuarve të tillë është e stigmatizuar sepse dënohet dy herë ; nga Gjykata kompetente në rast se i dëshmohet fajësia dhe institucionet përgjegjëse për lirim të parakohshëm në rast se i plotësojnë kushtet e parapara me ligj. KMDLNj mendon se vetëm gjykata përkatëse , në bazë të provave është kompetente ta shqiptojë masën e dënimit apo të lirimidit ndërsa , në kohën kur janë në vuajtje të dënimit ata duhet të kenë të drejta që u takojnë.

I nderuari z. President,

KMDLNj shpreson se do ta merrni shumë seriozisht këtë kërkesë në mënyrë që t'u ofrohet një mundësi personave të privuar nga liria , pavarësisht përkatësisë etnike , fetare , moshës dhe gjinisë , në bazë të sjelljeve të tyre të përfitojnë më shumë dhe të mos demotivohen sikur deri më tani. Humbja e përkohshme e lirisë nuk nënkupton humbje të përhershme të shpresës që pas gabimit të bërë , për të cilin e merr dënimin e merituar , të mos kthehet përsëri në familje dhe të kontribuojë në dobi të shoqërisë dhe shtetit .

Në fund të fundit , ashtu siç ka detyrim shteti të dënojë ata që vinë në kundërshtim me ligjin , po ashtu ka detyrim që personave të dënuar tu ofrojë një ofertë se çka mund të përfitojnë nëse me sukses e kalojnë programin e risocializimit . Me përjashtim të veprave që përjashtohen me ligj e që janë qartë të përcaktuara. Merreni shembull Shqipërinë që brenda një muaji i fali afërsisht 4000 të dënuar . KMDLNj , mbështetur në përvojën shumëvjeçare të monitorimit të Qendrave të Paraburgimit dhe Qendrave Korrektuese vlerëson se , së paku 35-40% të personave të privuar nga liria duhet të lirohen me kusht apo që burgu mund tu zëvendësohet me një masë tjetër alternative të dënimit. Ndhimoheni Shërbimin Korrektues të Kosovës të marrë veten dhe trajtoni kërkesat për falje pa diskriminuar askend , siç nuk ka ndodhur më parë. Nuk është falje nëse nga 650 kërkesa për falje , i falni 5 apo 10 të burgosur . Falni ata që e meritojnë , mos i falni të pamërituarit !

Me respekt,

Behxhet Sh. SHALA,

Drejtor Ekzekutiv i KMDLNj – së